



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK**

Nr. 562/112 Prot.

Tiranë, më 13.02 2025

**V E N D I M**

Nr. 29 dt. 13.02 2025

**“PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN E BRENDSHME PËR  
ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TË GRUPUARA (KURSIT TË SKIJIMIT,  
TURIZMIT DHE NOTIT)”**

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 4, gërma a, nenin 33 paragrafi 3, nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 7 paragrafi 4 gërma a dhe 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, Vendimin e Rektoratit nr. 34, datë 12.02.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.02.2025,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme për Zhvillimin e Aktiviteteve të Grupuar (Kursit të Skijimit, Turizmit dhe Notit” (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Administratorit të UST-së dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Agron KASA



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SPORTEVE INDIVIDUALE

RREGULLORE E BRENDSHME  
PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TE GRUPUARA  
(KURSIT TË SKIJIMIT, TURIZMIT DHE NOTIT)

MIRATUAR  
ME VENDIM SENATI NR.29 DATË 13.02.2025

TIRANE: 2025

### OËLLIMI

Të sigurojë mbarëvajtjen e kurseve si dhe realizimin e programit mësimor. Të pajisë studentin me njohuritë bazë teorike e praktike të skijimit, turizmit dhe notit.

### MËNYRA E ZHVILLIMIT

Kursi i skijimit, turizmit dhe notit si pjesë përbërëse e Programit Mësimor zhvillohet në periudhën e caktuar në strukturën mësimore akademike.

Për zhvillimin e këtyre kurseve Dekanati cakton drejtuesin e kursit, i cili është pedagog në U.S.T, pedagogët përgjegjës të grupeve sipas ndarjes që kryen Departamenti, orarin e jetës së brëndëshme në kamping. Ky orar është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë pjesëmarrësit.

Pedagogët dhe studentët janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri pikat e kësaj rregulloreje.

Për zhvillimin e këtyre kurseve Fakulteti me buxhetin e tij është i detyruar të pajisë pedagogët dhe studentët me të gjitha mjetet për zhvillimin e kursit, të sigurojë transportin vajtje-ardhje dhe qëndrimin në kamping (fjetje) dhe ushqim, konform ligjeve dhe vendimeve në fuqi.

Dekanati duhet të sigurojë për zhvillimin e këtij kursi mjekun, i cili është pedagog në U.S.T. ose i jashtëm dhe t'i caktojë atij detyra.

Drejtuesit e kursit, pedagogët shoqërues dhe mjeku i kursit formojnë Këshillin e Kursit. Këshilli i Kursit është organi vendimor për rastet e jashtëzakonshme. Në rastet kur mjeku është i jashtëm, Këshilli i Kursit përbëhet vetëm nga personeli/stafi i brëndshëm.

### DREJTUESI I KURSIT

Ka për detyrë:

- Të kontrollojë të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e kursit dhe të njoftojë menjëherë për mangësitë;
- Të hartojë grafikun e shpërndarjes së mjeteve me persona përgjegjës;
- Të hartojë orarin e brëndshëm në kamping, orarin e lëvizjeve me autobus dhe t'ua komunikojë të gjithë pjesëmarrësve në këtë kurs;
- Të organizojë sistemin sa më të shpejtë të pjesëmarrësve në kamping;
- Të kontrollojë zbatimin e Programit Mësimor gjatë gjithë ditëve të qëndrimit në kamping;
- Të kontrollojë mjetet e dhëna në përdorim (mjetet mësimore dhe ato të kampingut) për të parandaluar shpërdorimin;
- Të kontrollojë sasinë e ushqimit ditor që kjo t'i përgjigjet kuotës së miratuar;

- Të hartojë grafikun ditor me pedagogë përgjegjës, i cili do të ndjekë zbatimin e orarin e jetesës në kamping nga zgjimi deri në fjetje.
- Të kërkojë rregull dhe qetësi gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kursit;
- Për të gjitha problemet që mund të dalin, drejtuesi mbledh Këshillin e Kursit dhe merr vendimet përkatëse, deri në largimin nga kursi të studentëve që shkelin këtë Rregullore dhe Rregulloren e brëndëshme të U.S.T.

### **PEDAGOGU SHOOËRUES**

Ka për detyrë:

- Të njohë grupin mësimor që do të shoqërojë në kursin e skijimit, turizmit dhe notit;
- Të kujdeset për tërheqjen në afat të mjeteve mësimore;
- Të njoftojë grupin e tij për orarin e nisjes dhe orarin e jetës në kamping
- T'i bëjë të njohur studentëve të grupit mësimor:
  - a) Rregulloren e brëndëshme të kursit;
  - b) Mënyrën dhe format e vlerësimit;
- Është përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e mjeteve mësimore dhënë studentëve;
- Është përgjegjës për zbatimin e programit mësimor me grupin e tij dhe për zbatimin e orarit të jetës në kamping;
- Të gjithë pedagogët pjesëmarrës në Kursin e Skive , Notit dhe Turimit duhet të paraqesin pranë Rektoratit raportin e kontrollit mjeksor nga komisioni mjeko-ligjor.

### **MJEKU I KURSIT**

Ka për detyrë:

- Është përgjegjës direkt me të gjitha medikamentet e nevojshme për t'ju ardhur në ndihmë pjesëmarrësve në kurs.
- Të bëjë kontrollin ditor të ushqimit;
- Të shoqërojë grupet në zhvillimin e procesit mësimor, për të qënë sa më afër në rast aksidentesh duke I dhënë ndihmën e parë. Të marrë masa urgjente, në rast aksidentesh duke I shoqëruar deri në institucionin mjeksor dhe të largohet prej andej vetëm atëherë kur prezenca e tij është e panevojshme.
- Për të gjitha rastet e shkeljeve të rregullave higjieno-sanitare cilësisë së ushqimit etj, kur ndërhyrja e tij nuk jep rezultat , ai menjëherë njofton drejtuesin e kursit.

### **TË DHËNAT E DETYRAVE TË STUDENTIT**

Studenti pjesëmarrës në kursin e skjimit, turizmit dhe notit ka të drejtë:

- Të pajiset me të gjitha mjetet që disponon Fakulteti për zhvillimin e kursit;
- Të udhëtojë dhe të trajtohet me fondet e buxhetit të UST gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të kursit;
- Të njohë këtë rregullore dhe orarin e jetës në kamping;
- Të njohë programin mësimor dhe mënyrën e format e vlerësimit;
- Kohën e lirë që i jepet sipas jetës në kamping, ta përdorë pa shkelur pikat e kësaj rregulloreje;

Studenti ka për detyrë të marrë në ngarkim mjetet e nevojshme për zhvillimin e kursit dhe mjetet e jetesës dhe t'i ruajë ato.

Të zbatojë në mënyrë korrekte orarin e jetës në kamping;

Të mbajë shënime për pjesën teorike të kursit;

I ndalohet në mënyrë kategorike përdorimi i pijeve alkoolike gjatë gjithë kohës të qëndrimit në kamping;

Do të zhdemtojë të gjitha dëmtimet që do t'i kryejë gjatë jetesës në kamping;

Mban përgjegjësi të plotë për thyerjen e disiplinës dhe mos zbatimin e pikave të kësaj rregulloreje.

Studenti, i cili nuk arrin të shlyejë detyrimet e këtij kursi, i shlyen ato në vitin pasardhës. Në këtë rast Fakulteti nuk është i detyruar të justifikojë mungesat dhe efektet financiare do të përballohen nga vetë student.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Departamenti i Sporteve Individuale.

Për të gjitha ato problem që nuk trajtohen në këtë rregullore do të zbatohet Statuti dhe Rregullorja e brendëshme e UST.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Agron KASA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES  
DEPARTAMENTI I SPORTEVE INDIVIDUALE

RREGULLORE E BRENDSEME  
PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE TE GRUPUARA  
(KURSI TË SKIJIMIT, TURIZMIT DHE NOTIT)

MIRATUAR  
ME VENDIM SENATI NR.29 DATË 13.02.2025

TIRANE: 2025

### OËLLIMI

Të sigurojë mbarëvajtjen e kurseve si dhe realizimin e programit mësimor. Të pajisë studentin me njohuritë bazë teorike e praktike të skijimit, turizmit dhe notit.

### MËNYRA E ZHVILLIMIT

Kursi i skijimit, turizmit dhe notit si pjesë përbërëse e Programit Mësimor zhvillohet në periudhën e caktuar në strukturën mësimore akademike.

Për zhvillimin e këtyre kurseve Dekanati cakton drejtuesin e kursit, i cili është pedagog në U.S.T, pedagogët përgjegjës të grupeve sipas ndarjes që kryen Departamenti, orarin e jetës së brëndëshme në kamping. Ky orar është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë pjesëmarrësit.

Pedagogët dhe studentët janë të detyruar të zbatojnë me përpikmëri pikat e kësaj rregulloreje.

Për zhvillimin e këtyre kurseve Fakulteti me buxhetin e tij është i detyruar të pajisë pedagogët dhe studentët me të gjitha mjetet për zhvillimin e kursit, të sigurojë transportin vajtje-ardhje dhe qëndrimin në kamping (fjetje) dhe ushqim, konform ligjeve dhe vendimeve në fuqi.

Dekanati duhet të sigurojë për zhvillimin e këtij kursi mjekun, i cili është pedagog në U.S.T. ose i jashtëm dhe t'i caktojë atij detyra.

Drejtuesit e kursit, pedagogët shoqërues dhe mjeku i kursit formojnë Këshillin e Kursit. Këshilli i Kursit është organi vendimor për rastet e jashtëzakonshme. Në rastet kur mjeku është i jashtëm, Këshilli i Kursit përbëhet vetëm nga personeli/stafi i brëndshëm.

### DREJTUESI I KURSIT

Ka për detyrë:

- Të kontrollojë të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e kursit dhe të njoftojë menjëherë për mangësitë;
- Të hartojë grafikun e shpërndarjes së mjeteve me persona përgjegjës;
- Të hartojë orarin e brëndshëm në kamping, orarin e lëvizjeve me autobus dhe t'ua komunikojë të gjithë pjesëmarrësve në këtë kurs;
- Të organizojë sistemin sa më të shpejtë të pjesëmarrësve në kamping;
- Të kontrollojë zbatimin e Programit Mësimor gjatë gjithë ditëve të qëndrimit në kamping;
- Të kontrollojë mjetet e dhëna në përdorim (mjetet mësimore dhe ato të kampingut) për të parandaluar shpërdorimin;
- Të kontrollojë sasinë e ushqimit ditor që kjo t'i përgjigjet kuotës së miratuar;

- Të hartojë grafikun ditor me pedagogë përgjegjës, i cili do të ndjekë zbatimin e orarin e jetesës në kamping nga zgjimi deri në fjetje.
- Të kërkojë rregull dhe qetësi gjatë gjithë kohës së zhvillimit të kursit;
- Për të gjitha problemet që mund të dalin, drejtuesi mbledh Këshillin e Kursit dhe merr vendimet përkatëse, deri në largimin nga kursi të studentëve që shkelin këtë Rregullore dhe Rregulloren e brëndëshme të U.S.T.

### PEDAGOGU SHOOËRUES

Ka për detyrë:

- Të njohë grupin mësimor që do të shoqërojë në kursin e skijimit, turizmit dhe notit;
- Të kujdeset për tërheqjen në afat të mjeteve mësimore;
- Të njoftojë grupin e tij për orarin e nisjes dhe orarin e jetës në kamping
- T'i bëjë të njohur studentëve të grupit mësimor:
  - a) Rregulloren e brëndëshme të kursit;
  - b) Mënyrën dhe format e vlerësimit;
- Është përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e mjeteve mësimore dhënë studentëve;
- Është përgjegjës për zbatimin e programit mësimor me grupin e tij dhe për zbatimin e orarit të jetës në kamping;
- Të gjithë pedagogët pjesëmarrës në Kursin e Skive , Notit dhe Turimit duhet të paraqesin pranë Rektoratit raportin e kontrollit mjeksor nga komisioni mjeko-ligjor.

### MJEKU I KURSIT

Ka për detyrë:

- Është përgjegjës direkt me të gjitha medikamentet e nevojshme për t'ju ardhur në ndihmë pjesëmarrësve në kurs.
- Të bëjë kontrollin ditor të ushqimit;
- Të shoqërojë grupet në zhvillimin e procesit mësimor, për të qënë sa më afër në rast aksidentesh duke i dhënë ndihmën e parë. Të marrë masa urgjente, në rast aksidentesh duke i shoqëruar deri në institucionin mjeksor dhe të largohet prej andej vetëm atëherë kur prezenca e tij është e panevojshme.
- Për të gjitha rastet e shkeljeve të rregullave higjeno-sanitare cilësisë së ushqimit etj, kur ndërhyrja e tij nuk jep rezultat , ai menjëherë njofton drejtuesin e kursit.

### **TË DHËNAT E DETYRAVE TË STUDENTIT**

Studenti pjesëmarrës në kursin e skjimit, turizmit dhe notit ka të drejtë:

- Të pajiset me të gjitha mjetet që disponon Fakulteti për zhvillimin e kursit;
- Të udhëtojë dhe të trajtohet me fondet e buxhetit të UST gjatë gjithë ditëve të zhvillimit të kursit;
- Të njohë këtë rregullore dhe orarin e jetës në kamping;
- Të njohë programin mësimor dhe mënyrën e format e vlerësimit;
- Kohën e lirë që i jepet sipas jetës në kamping, ta përdorë pa shkelur pikat e kësaj rregulloreje;

Studenti ka për detyrë të marrë në ngarkim mjetet e nevojshme për zhvillimin e kursit dhe mjetet e jetesës dhe t'i ruajë ato.

Të zbatojë në mënyrë korrekte orarin e jetës në kamping;

Të mbajë shënime për pjesën teorike të kursit;

I ndalohet në mënyrë kategorike përdorimi i pijeve alkoolike gjatë gjithë kohës të qëndrimit në kamping;

Do të zhdemtojë të gjitha dëmtimet që do t'i kryejë gjatë jetesës në kamping;

Mban përgjegjësi të plotë për thyerjen e disiplinës dhe mos zbatimin e pikave të kësaj rregulloreje.

Studenti, i cili nuk arrin të shlyejë detyrimet e këtij kursi, i shlyen ato në vitin pasardhës. Në këtë rast Fakulteti nuk është i detyruar të justifikojë mungesat dhe efektet financiare do të përballohen nga vetë student.

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje ngarkohet Departamenti i Sporteve Individuale.

Për të gjitha ato problem që nuk trajtohen në këtë rregullore do të zbatohet Statuti dhe Rregullorja e brendëshme e UST.

**KRYETARI I SENATIT**

**Prof. Dr. Agron KASA**